VENDIM
Nr. 359, datë 1.12.2023

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË "SWISS BALANCING POOL" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2303/4 prot., datë 24.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë 'Swiss Balancing Pool' sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Swiss Balancing Pool" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2303 prot., datë 17.10.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 310, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.11.2023 dhe 2.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 9.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 2302/5 prot., datë 1.11.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin/saktësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Kjo shkresë u kthye nga shërbimi postar, me shënimin "I panjohur", ndaj në vijim, ERE njoftoi shoqërinë nëpërmjet adresës së *email*-it dhënë nga shoqëria, në datë 7.11.2023.

- Në mbledhjen e planifikuar të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 1.12.2023, shoqëria me shkresën me nr. 2302/7 prot., datë 23.11.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues për aplikimin e saj, pasi është njohur me vendimin nr. 310/2023 në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ky dokumentacion u dorëzua përpara shqyrtimit të relacionit nr. 2303/4 prot., datë 24.11.2023, nga Bordi i ERE-s.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga shoqëria, në kuadër të plotësimit të dosjes së aplikimit dhe nevojës që mund të lindë për ndonjë korrespondencë pas shqyrtimit të dokumentacionit, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë "Swiss Balancing Pool" sh.p.k., për t'u licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë "Swiss Balancing Pool" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Swiss Balancing Pool" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti